



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 54

Prishtinë, më 10 prill 2013, në orën 14:35

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi dhe Petar Miletqi.

Mungoi: Berat Buzhala.

Delegacioni i Komisionit për Punë të Jashtme nga Kuvendi Kombëtar i Hungarisë ishte në përbërje: Tibor Mihaly Balla, kryetar, Tamas Gabor Nagy, nënkryetar, Vilmos Szabo, anëtar, Noemi Koranyi, këshilltare dhe Lorant Balla, ambasador i Republikës së Hungarisë në Kosovë.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha - OSBE, Gjenis Haxhimehmeti, praktikant.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Takim me delegacionin e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë;
2. Diskutim lidhur me Draft-Rezolutën e KPJ-së të Parlamentit Evropian për procesin e integritetit evropian të Kosovës;
3. Të ndryshme.

Albin Kurti – Duke i shprehur mirëseardhje delegacionit të Kuvendi Kombëtar të Hungarisë, falënderoi Hungarinë për njohjen e shpejtë të Republikës së Kosovës, duke shprehur interesim për marrëdhënie të mira bilaterale dhe për bashkëpunim në kuadër të forumeve të ndryshme multilaterale. Kurti, me këtë rast përmendi dy sfida kryesore të Kosovës, të cilat janë, Mitrovica e ndarë dhe zhvillimi ekonomik i vendit. Gjithashtu, ai përmendi mungesën e prodhimit në Kosovë dhe papunësinë e madhe, duke shtuar se të gjitha subjektet politike të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë për integrim në NATO dhe BE, por ceku mungesën e qasjeve korrekte të faktorëve ndërkombëtarë, posaçërisht të Bashkimit Evropian, karshi Serbisë.

Tibor Mihaly Balla – Falënderoi Komisionin për ftesën dhe mikpritjen e tyre. Përgëzoi Kosovën për pavarësinë e saj dhe për të arriturat gjatë pesë viteve të fundit, duke theksuar se jetën në Prishtinë e sheh si një jetë normale, si në çdo vend tjetër të Evropës. Ai premtoi se Hungaria do ta mbështes Kosovën drejt integritetit evropian dhe tha se do ta përkrah njohjen e Kosovës, mirëpo, hapat e parë Kosova duhet t'i bëjë vetë. Ai përmendi edhe normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Sabri Hamiti – I shprehu mirëseardhje delegacionit dhe e falënderoi për përgëzimin me rastin e pesë vjetorit të pavarësisë së Kosovës dhe për raportet në mes të dy vendeve. Hamiti theksoi se Kosova ka kaluar vite të vështira dhe të pandalshme drejt pavarësisë dhe lirisë së vendit. Ai vlerësoi ndihmën që Kosova ka pasur gjatë dhjetë viteve të fundit nga Parlamenti i Hungarisë, veçmas nga Projekti për mbështetjen e mëtutjeshme të Kuvendit të Kosovës. Me këtë rast, Hamiti kërkoi ndihmë nga Parlamenti i Hungarisë dhe nga Komisioni i tyre, lidhur me kontaktet me vendet e tjera, mundësisht me vendet që nuk e kanë njohur ende shtetin e Kosovës. Gjithashtu, theksoi se shpesh herë, pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën bëjnë pengesë në procesin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Skender Hyseni – Shprehu kënaqësi për mundësinë e takimit dhe bisedimit me delegacionin e komisionit homolog të Kuvendit Kombëtarë të Hungarisë. Duke pasur parasysh situatën momentale në Kosovë, ai i bëri thirrje Parlamentit të Hungarisë që të vazhdojë ta përkrahë Kosovën, posaçërisht lidhur me njohjet e mëtutjeshme nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Mosnjohja nga pesë vendet anëtare të BE-së, tha Hyseni se është shndërruar në një bllokadë diplomatike dhe politike për Kosovën. Ai po ashtu, theksoi se qëndrimi neutral i BE-së për statusin e Kosovës është duke i shkaktuar Kosovës pengesa të mëdha lidhur me procesin e integritetit në BE. Hyseni më tej theksoi se Hungaria është në një pozitë që mund ta përkrah Kosovën duke lobuar për njohjen e saj, veçanërisht në pesë vendet anëtare të BE-së.

Donika Kadaj-Bujupi – Delegacionit hungarez i dëshiroi mirëseardhje dhe e falënderoi për mbështetjen e dhënë Kosovës, duke shtuar se Kosova është një vend i mundësive dhe inkurajoi delegacionin që të kalojë nga pozita e mbështetjes, në pozitë partneriteti. Ajo përmendi papunësinë e madhe e cila mbretëron në Kosovë dhe nevojën e investimeve të huaja. Gjithashtu, ajo theksoi se është e nevojshme përkrahja për procesin e liberalizimit të vizave.

Hydajet Hyseni – Duke shprehur mirënjohje për mbështetjen e veçantë të shtetit hungarez, tha se obligimin që e ndiejmë, më së miri mund ta shprehim duke e ndërtuar një të ardhme të lirë, demokratike dhe prosperuese. Tani pas luftës, tha se duhet ta fitojmë paqen, që nuk është aspak e lehtë dhe ka sfida të llojllojshme. Hyseni theksoi nevojën e mësimin nga përvoja e Hungarisë dhe ndihmën e saj në procesin e integritimeve në strukturat euro-atlantike, si dhe të atyre mundësive të cilat i ofron diplomacia parlamentare, që tek ne është lënë pak anash. Gjithashtu, në mungesë të qasjes së Kosovës në institucione ndërkombëtare, ai theksoi se nuk është arritur të prezantohet e vërteta për Kosovën dhe në këtë drejtim kërkoi ndihmë për nevojën e prezantimit real të Kosovës.

Albin Kurti – Ritheksoi se dy nga pesë vendet anëtare të BE-së, të cilat ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, janë vende fqinje të Hungarisë. Lidhur me liberalizimin e vizave për Kosovën, Kurti theksoi se edhe pse ne jemi në zemër të Ballkanit, në një mënyrë jemi plotësisht të izoluar. Ai e krahasoi faktin që, pa viza, nga Kosova mund të shkosh vetëm në katër vende, ndërsa nga Afganistani mund të shkosh në 16 vende. Në Kosovë, tha se kemi EULEX-in, me Misionin për Sundimin e Ligjit në Kosovë, i cili ka fuqi ekzekutive dhe imunitet ndaj ndjekjeve penale. Kurti theksoi se sigurisht që ne duam paqe, siguri dhe stabilitet, mirëpo, ne më shumë duam demokraci, zhvillim dhe drejtësi. Në anën tjetër, ai përmendi problemin e vazhdueshëm me Serbinë, duke thënë se Serbia po kërkon për Serbët në Kosovë atë çka nuk është e gatshme t'ju japë shqiptarëve në Luginën e Preshevës, boshnjakëve në Sanxhak, dhe vlllehve në Provincën e Timokut, duke shtuar se kërkon refleksionin e delegacionit lidhur me këto çështje.

Tibor Mihaly Balla – Theksoi se Parlamenti i Hungarisë e mbështetë Kosovën në procesin e integritimeve evropiane si dhe në procesin e liberalizimit të vizave. Ai tha se i kupton problemet e Kosovës, mirëpo vazhdimi i dialogut Prishtinë-Beograd, është i rëndësishëm. Balla gjithashtu shprehi mendimin se duhet gjetur një kompromis në mënyrë që të ketë stabilizim në rajon.

Vilmos Szabo – Duke e falënderuar Komisionin për ftesën, tha se e kupton pakënaqësinë e Kosovës për pesë vendet që nuk e kanë njohur ende Kosovën. Szabo theksoi se është e rëndë edhe për Serbinë edhe për Kosovën, që të gjejnë kompromis, por, nuk ka zgjidhje tjetër.

Emilija Rexhepi – Pasi i dëshiroi mirëseardhje delegacionit, theksoi se Kosova ka një Kushtetutë të mirë dhe ligje të mira për të drejtat e njeriut, mirëpo, ato duhet të zbatohen. Ajo e falënderoi Ambasadën e Hungarisë për mbështetjen e dhënë komuniteteve.

Takimi përfundoi në orën 15:35.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit